ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **204-24-13526-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Sigurim fizik i objekteve për nevojat e MINT**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**BESA SECURITY SH.P.K.**
NUI	**810500406**
Adresa	**Rr. Jusuf Gërvalla nr.64**
Vendi	**Prishtinë**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**049/738267**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Granit Sogojeva**
Adresa elektronike	**prokurimi@besasecurity.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**26.03.2025**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit	**Yll Zekaj**
Adresa e plotë	**Rr. Holger Peterson, Objekti Punetori Group, Lokali Nr 1, Prishtine**
Numri i Telefonit	**044/375730**
Numri i faks-it	**N/A**
Adresa elektronike	**yll.zekaj@gmail.com**

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Sigurim fizik i objekteve për nevojat e MINT

- Dosja e Tenderit për Kontratën Publike Kornizë- Shërbim e hapur me datë 26.12.2024

- Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues 10.03.2025

- Vendimi mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit i datës 13.03.2025

- Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues 18.03.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒ **Jo** ☐

Nuk aplikohet

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me datën 10.03.2025 në pra 09:14 në platformën e-prokurimi kemi pranuar njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues për përzgjedhjen e kompanisë "MEB LLC" si operatori ekonomik i suksesshëm ne tenderin "Sigurim fizik për nevojat e MINT".

Me datë 14.03.2025 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim dhe me datë 18.03.2025 kemi pranuar vendimin Nr.1083/03 mbi refuzimin si të pabazuar të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e dispozitave te Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregullores për prokurim publik Nr. 001/2022:

1. **Mosrespektimi i Ligjit për Prokurimin Publik (LPP):**

Neni 7 - Barazia në trajtim/jo diskriminimi.

Neni 59.4 - Vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.

Neni 61 - Tenderët jo normalisht të ulët.

2. **Shkelja e Rregullores së Prokurimit Publik Nr. 001/2022:**

Neni 41.6 - Mospërdorimi i formularit standard për tenderët jonormalisht të ulët.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. **Zhvillimi i aktiviteteve të Prokurimit nga ana e Autoriteti Kontraktues (Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë)**

1. Autoriteti Kontraktues (MINT), më datë 10.03.2025, ka shpallur Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (AK), për aktivitetin e prokurimit nr. 204-24-13526-2-1-1. Ky njoftim/vendim ka shpallur fituese të kontratës kompaninë e sigurimeve "MEB LLC", e cila ka ofruar një ofertë me vlerën e përgjithshme prej 123,500.00 EUR. Sipas njoftimit, pas shqyrtimit të ofertave dhe verifikimeve përkatëse, janë eliminuar të gjitha kompanitë e tjera që kanë marrë pjesë në procesin e tenderimit, pasi nuk kanë plotësuar kushtet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet specifik, duke i njoftuar

me letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm me konstatimin se "tenderi juaj nuk qe tenderë me çmimin me te ulet ne mesin e tenderëve qe plotësonin kërkesat e dhëna ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit".

2. Me datë 13.03.2025, Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë një vendim për pezullimin e aktivitetit të prokurimit nr. 204-24-13526-2-1-1.

3. Me datë 18.03.2025 kemi pranuar Vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim si të pabazuar me të cilën vërtetohet njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit "Sigurim fizik për nevojat e MINT" MINT 204-24-13526-211.

II. **SHKELJET e AK në procesin e realizimit te aktiviteteve e prokurimit nr.204-24-13526-211**

4. Njoftimi i Autoritetit Kontraktues (AK) për shpalljen e Operatorit Ekonomik (OE) si të pasuksesshëm, i datës 10.03.2025 është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi në fushën e prokurimit publik.

5. Kriteri i vendosur nga Autoriteti Kontraktor (AK) për dhënien e tenderit parashikonte që paga e punonjësve të operatorëve ekonomikë të mos ishte më e ulët se 350 euro neto. Ky ishte një kusht thelbësor për sigurimin e kushteve të drejta dhe të dinjitetshme të punës për të gjithë punonjësit që do të angazhoheshin në kuadër të këtij tenderi dhe një obligim ligjor sipas vendimit te qeverise për përcaktimin e pagës minimale.

6. Bazuar në analizën e detajuar të ofertës së pranuar nga AK, ju sjellim në vëmendje sa vijon: Oferta e OE te rekomanduar dhe e pranuar nga AK është 123,500.00 € ose 104,661.02 € (NETO) për 50,000 orë pune, që korrespondon me 2.47 € (bruto) ose 2.09 € (neto) për një orë pune të rregullt. Kurse kriteri i përcaktuar ne dosjen e tenderit nga ana e AK përcaktonte qe paga e punëtorëve te mos ishte me e ulet se paga mujore prej 377.57 € bruto (350.00 € neto) ose 2.15 € (neto) për një orë pune. Duke marrë në konsideratë faktin se EO fitues do të paguaj punëtorët me 2.09 € për orë pune, ndërkohë që paga minimale e punëtorëve nuk mund të jetë më e ulët se 2.15 € për orë pune, pa llogaritur asnjë shpenzim tjetër, rezulton se Autoriteti Kontraktues ka kryer shkelje duke ia dhënë kontratën OE me këtë tenderin e ofertuar nen çmimet e përcaktuara me dosjen e tenderit.

7. Për më tepër: Përveç pagës minimale, e cila ishte e paraparë si kriter në dosjen e tenderit, punëdhënësi është ligjërisht i obliguar të paguajë kontribut shtesë minimal prej 5% mbi pagën bazë për kontributin pensional, siç e kërkon legjislacioni në fuqi. Gjithashtu, në përputhje me Nenin 56 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, punonjësve u takon një përqindje shtesë mbi pagën bazë për punën jashtë orarit të rregullt të punës. Kjo dispozitë ligjore përcakton kompensimin e punëtorëve që angazhohen në punë shtesë, jashtë orarit të zakonshëm të punës, dhe për të siguruar që ata të marrin një pagesë të drejtë dhe të përshtatshme për angazhimin e tyre shtesë. Kjo nënkupton që, përveç pagës bazë, punëdhënësi është i obliguar të marrë parasysh edhe pagesat për kontributet pensionale dhe kompensimin për punën jashtë orarit të caktuar. Megjithatë, operatori ekonomik i shpallur si fitues i tenderit nuk ka arritur të përmbushë këtë kërkesë me çmimin e ofertuar. Në përputhje me Nenin 59.4 të Ligjit të Prokurimit Publik "*Autoriteti*

kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit", ky operator ekonomik duhet të konsiderohet si i papërgjegjshëm, pasi nuk ka respektuar kriteret e kërkuara që paga e punëtorëve të mos ishte më e ulët se 350.00 euro neto. Nëse këto aspekte nuk janë marrë parasysh në ofertën e operatorit ekonomik dhe në vlerësimin e autoritetit kontraktues, paraqesin shkelje të legjislacionit të punës dhe të kushteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

8. Tenderi i dorëzuar nga OE fitues është ne kundërshtim edhe me nenin 61.1 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe 41 të Rregullores për Prokurim Publik qe kanë te bëjnë me ***tenderët jonormalisht të ulët.*** Në rastin kur një operator ekonomik dorëzon një tender që është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues ka detyrimin ligjor të dërgojë një kërkesë me shkrim tek tenderuesi. Kjo kërkesë duhet të përfshijë dy elemente kryesore: (i) një ndarje të elementeve përbërëse të ofertës dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, siç është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni. Kjo dispozitë ligjore ka për qëllim të sigurojë që ofertat me çmime shumë të ulëta janë të qëndrueshme dhe nuk rrezikojnë shkeljen e rregullave të punës, si dhe të sigurojnë që operatorët ekonomikë të respektojnë të gjitha kushtet ligjore dhe kontraktuale. Kurse sipas nenit 41.6 të Rregullores për prokurimin publik përcaktohet se "*Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore,* ***një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jonormalisht të ulët"***

9. Autoriteti Kontraktues ka dështuar të përfillë dispozitë e lartcekura të Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores për Prokurimin Publik qe kanë te bëjnë me ***tenderët jonormalisht të ulët***. Ne rastin konkret nuk është kërkuar nga operatori ekonomik ***deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jonormalisht të ulë*** dhe as sqarime të mëtejshme për mënyrën se si operatori do të mbulojë kostot e tenderit me shumën e ofertuar, pa shkelur Ligjin e Punës dhe vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për pagën bazë.

10. Autoriteti kontraktues në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik ka refuzuar pretendimin ankimore të OE Besa Security lidhur me faktin qe operatorit ekonomik i rekomanduar me tenderin e tij shkel kriteret e dosjes se tenderit "se paga e punëtorëve nuk duhet te jete me e ulet se 350 euro neto" duke u vet mjaftuar me një deklaratë të operatorit ekonomik se i njëjti "***qe do t'iu përmbahet pagës prej 350 euro neto",*** pa bere verifikim shtese dhe pa iu përmbajtur obligimeve ligjore për deklarate te detajuar me përmbajtjen e përcaktuar ne nenin 41.6 te Rregullores për Prokurim publik.

Kërkesa e BESA SECURITY SH.P.K.

Duke u bazuar në deklarimet dhe argumentet e paraqitura më lart, Operatorit Ekonomik (OE) i eliminuar si parashtrues i kësaj ankese i propozojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) që, pas shqyrtimit të fakteve të paraqitura dhe mbështetjes të plotë në Ligjin për Prokurimin Publik (LPP) dhe Rregulloren 001/2022 për Prokurimin Publik, të nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **APROVOHET**, ankesa e BESA SECURITY SHPK në tërësi si e bazuar.

2. **ANULOHET** njoftimi i AK, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për shpalljen e KS "MEB LLC" si OE i suksesshëm në aktivitetin e prokurimit "Sigurim fizik për nevojat e MINT" me nr.204-24-13526-2-1-1

OBLIGOHET AK (Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë) që të bëjë rivlerësimin e tenderit përmes një komisioni vlerësues profesional.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzime gjatë përgatitjes së Kërkesave për Ri-shqyrtim pranë Autoriteti Kontraktues dhe Ankesës në Organin Shqyrtues të Prokurimit si dhe humbjeve të fitimeve të planifikuara.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*